

gjurmët e gjakut dhe çantën e Bashkimit *Te Tabat*. Vite me radhë pas kësaj ngjarjeje, familja e Bashkimit i ka kaluar në kërkim të trupit të tij. Vetëm në vitin 2003, familjarët kanë mësuar se forcat serbe e kishin varrosur një djalosh në Gjurgjevikun e Madh/Veliki Đurđevik [Klinë/Klina], në muajin mars të vitit 1998. Në muajin qershor të vitit 2003, familjarët e kanë zhvarrosur varrin e përmendur dhe e kanë identifikuar Bashkimin në bazë të dhëmbëve dhe rrobave të trupit. E kanë varrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Tushilë/Tušilje.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-32803; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Xhafer (Miftar) Syla

(18.01.1962, shqiptar nga Tërncac/Trnavce, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë)

Xhaferi me familje dhe nënën jetonin në bashkësi familjare me familjet e dy vëllezërve të tij që punonin jashtë vendit. E tërë familja i numëronte 17 anëtarë. Në fillim të vitit 1998, në Tërncac/Trnavce kanë arritur ushtria dhe policia serbe. U vendosën në shtoren e cila ishte afër familjes Syla. Pas masakrës në Likoshan/Likošane [të shikohen regjistrimet], bashkëshortja e Xhaferit me fëmijët kaluan më 2.03.1998 te prindërit e saj në Zhabarin e Epërm/Gornje Žabare. Nuk kishte kurrfarë njohuri për bashkëshortin deri më 8.03.1998. Atëherë, i ati kishte mësuar se Xhaferin e kishin vrarë forcat serbe më 5.03.1998, para shtëpisë [Tërncac/Trnavce]. Po atë ditë, forcat serbe e kishin sulmuar fshatin dhe e kanë përndjekur popullatën civile. Vetëm dy ditë më vonë, vendasit ia arritën që ta varrosnin Xhaferin në varrezat lokale. Pas lufte, në muajin tetor të vitit 2000, mbetjet mortore të Xhaferit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Tërncac/Trnavce.

**Burimet:** deklarata H.S, FDH-40650; J. Osmani, *Krimet...*, II, 308.

### Muhamet (Beqir) Miftari

(17.05.1949, shqiptar nga Vitaku/Vitak, komuna e Skënderajt/Srbica, floktar, shtatë fëmijë)

Muhameti ka qenë floktar dhe e kishte punëtorinë në fshatin Runik/Rudnik. Me bashkëshorten Mehremen dhe fëmijët jetonin në Vitak. Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze më 5.03.1998 [të shikohen regjistrimet], Muhameti dhe bashkëshortja i çuan fëmijët te prindërit e Mehremes në Kotorr/Kotore, ndërsa ata u kthyen dhe ndenjen në shtëpi. Pas disa ditësh, vlerësuan se situata u qetësua pakëz dhe në ditën e premte, më 13.03.1998, shkuan që t'i merrnin fëmijët. Në Vitak arritën nga ora 19:00. Sapo dolën nga makina, pranë tyre u paraqitën papritmas gjashtë burrat e panjohur. E morën dhe e ndanë Muhametin nga familjarët dhe shtënë mbi të, duke e privuar nga jeta në prani të Mehremes dhe fëmijëve. Pastaj, u larguan pa e thënë asnjë fjalë. Të nesërmen, familjarët e kanë varrosur Muhametin në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata M.M, FDH-32804; KKMCKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 58, FDH-23857.

### Marigona (Behram) Vojvoda

(12.06.1997, shqiptare nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica)

Marigonën e kanë plagosur më 27.03.1998, në oborrin e Sahit Zejnullahit, në Llaushë/Lauša. Ishte kjo ditë kur forcat serbe e bombarduan fshatin dhe kur nëna e Marigones, Mevludja me fëmijët u strehuan në *Mëshallën Zejnullahi*, që gjendet në kodër përmbi fshat. Marigona ishte në djep kur u qëllua nga cifla e predhës që ka rënë në oborr. Mevludja e ka çuar menjëherë Marigonën në Shtëpinë e Shëndetit në Skënderaj/Srbica, nga ku e nisën me autoambulancë për në Prishtinë/Priština. Marigona ka ndërruar jetë në rrugë e sipër, në fshatin Polac/Poljance, ku jetonin prindërit e Mevludes. Marigonën e kanë varrosur më 28.03.1998 në varrezat e fshatit Polac/Poljance.

**Burimet:** deklarata M.V, FDH-40674; J. Osmani, *Krimet...*, II, 310.

### Mujë (Sadik) Ahmeti

(1928, shqiptar nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tetë fëmijë)